



BULETINI I KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

Maj 2022

BULETINI I KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

Maj 2022

AKTIVITETET E KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

**(Në këtë edicion të këtij buletini pasqyrohen
aktivitetet për muajin maj të vitit 2022)**

Mbahet takimi i Komisionit për Çështje Normative

Komisioni për Çështje Normative i KPK-së mbajti takimin e tij të radhës, në të cilin shqyrtoi Udhëzuesin për transferimin dhe avancimin e prokurorëve të shtetit, i cili përmban udhëzime të detajuara për procedurën e transferimit dhe avancimit të prokurorëve.



Anëtarët e këtij Komisioni shqyrtuan edhe draftin e parë të Rregullores për rekrutimin, provimin, emërimin dhe riemërimin e prokurorëve të shtetit, i përgatitur fillimisht nga stafi i administratës së sistemit prokurorial, i cili merret me ofrimin e mbështetjes në procesin e rekrutimit, emërimit dhe riemërimit të prokurorëve të shtetit.

Kryesuesi i KPK-së pritet në takim nga Ambasadori i Gjermanisë në Kosovë

Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës është pritur në takim nga Ambasadori i Gjermanisë në Kosovë, me ç'rast diskutuan për angazhimet dhe tejkalimin e sfidave aktuale, bashkëpunimi në fushën e ndihmës juridike ndërkombëtare, realizimi i planeve të punës dhe forcimi i besimit të qytetarëve në sistemin prokurorial.



Ambasadori gjerman, Rohde, theksoi gatishmërinë e tij për thellimin e bashkëpunimit në fushën e sundimit të rendit dhe ligjit dhe në forcimin e llogaridhënies, transparencës dhe integritetit të sistemit prokurorial në Kosovë.

Mbahet takimi i 215-të i Këshillit Prokurorial të Kosovës

Këshilli Prokurorial i Kosovës mbajti takimin e 215-të me radhë, në të cilin raportuan kryeprokurorë e prokurorive të Republikës së Kosovës për aktivitetet e zhvilluara në periudhën janar-mars të vitit 2022.

Anëtarët e KPK-së miratuan Raportin vjetor të mekanizmit përcjellës ndërinstitucional për veprat penale karakteristike për vitin 2021 dhe shpallen transferimin e përhershëm në departamentet e përgjithshme të shtatë prokurorëve në Prokurorinë Themelore të Prishtinës dhe një prokurori në Prokurorinë Themelore të Ferizajt.



Po ashtu është bërë edhe plotësimndryshimi i Vendimit të KPK-së për Komisionin për Transferim dhe Avancim të Prokurorëve të Shtetit, me ç'rast në vend të ish-Kryeprokurorit të Shtetit, u caktua Ushtruesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, në cilësinë e kryesuesit të këtij Komisioni.

Mbahet takimi i Komisionit për Administrimin e Prokurorive

Komisioni për Administrimin e Prokurorive mbajti takimin e radhës, me ç'rast diskutoi për hartimin e analizës për nevojat e transferimit të prokurorëve në sistemin prokurorial.



Gjithashtu u diskutua edhe për vizitën e Grupit punes për monitorimin e zbatimit të SMIL-it në Prokurorinë Themelore të Mitrovicës dhe në Prokurorinë Themelore të Prishtinës, me ç'rast janë diskutuar për mënyrën e zbatimit, kontrollit të përdorimit të SMIL-it dhe cilësisë së të dhënave, si dhe rekomandimet e ndryshme për ngritjen e efikasitetit në punë.

Diskutohet për draftimin e akteve nënligjore me Zyrën e BE-së

Kryesuesi i Komisionit për Çështje Normative dhe Ushtruesi i Detyrës së Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të KPK-së pritën në takim punë



përfaqësuesit e Zyrës së BE-së në Kosovë, me ç'rast diskutuan çështjet që kanë të bëjnë me fushën e draftimit të akteve nënligjore dhe për rëndësinë e veçantë të këtyre akteve, sepse përmes tyre synohet të bëhet rritja e efikasitetit të punës në sistemin prokurorial.

Kryesuesi i KPK-së priti në takim Drejtorin e INL-së

Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës priti në takim Drejtorin e Zyrës për Çështje Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe Zbatimin e Ligjit (INL dhe përfaqësuesit e tjerë të Ambasadës Amerikane në Prishtinë.



Në takim, u diskutua për përmirësimin dhe avancimin e ndërmjetësitit dhe promovimit të tij nga ana e prokurorëve, ku u shpreh gatishmëria e dyanshme për të vazhduar bashkëpunimin, me qëllim të ngritjes së efikasitetit dhe transparencës së sistemit prokurorial në Kosovë.

Mbahet takim i njësisve organizative të SKPK-së

Ushtruesi i Detyrës së Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës mbajti një takim pune me udhëheqësit e njësisve organizative të SKPK-së.



Me këtë rast është diskutuar për proceset aktuale të punës dhe koordinimin e tyre në përputhje me zhvillimet dhe orientimet e planifikuara në planet e punës.

Komisioni mbikëqyrës për lëndët e korrupsionit dhe krimeve ekonomike vizitoi Prokurorinë Themelore të Prishtinës

Komisioni Mbikëqyrës për Lëndët e Korrupsionit dhe Krimeve Ekonomike vizitoi Prokurorinë Themelore të Prishtinës.



Me këtë rast, në kuadër të angazhimeve për zbatimin e Strategjisë së sistemit prokurorial 2022-2024 dhe Planit të veprimit, në këtë takim janë diskutuar lëndët e korrupsionit dhe krimeve ekonomike, trajtimi që iu bëhet atyre dhe sfidat që ndërlidhen me këtë prokurori.

Mbahet takim dyditor i Komisionit për Çështje Normative

Komisioni për Çështje Normative mbajti një takim dyditor, në të cilin morën pjesë Ushtruesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, anëtarët e Këshillit Prokurorial, përfaqësuesit e Ambasadës Amerikane, të projektit EUKOJUST dhe të Zyrës së Bashkimit Evropian.



Me këtë rast vazhdoi draftimi i Rregullores për rekrutimin, emërimin dhe riemërimin e prokurorëve të shtetit, i cili ka një rëndësi të veçantë për sistemin prokurorial të Kosovës.

Komisioni shqyrtoi kërkesat për staf shtesë dhe projektet kapitale të planifikuara për periudhën 2023-2025

Komisioni për Buxhet, Financa dhe Personel i Këshillit Prokurorial të Kosovës mbajti takimin e radhës.

Qëllimi i këtij takimi ishte shqyrtimi i kërkesave për pozita shtesë të kërkuara nga të gjitha prokuroritë dhe njësitë e tjera të Këshillit Prokurorial të Kosovës, kërkesa këto, që i paraprijnë Kërkesës buxhetore për vitin 2023 dhe vlerësimeve të hershme për vitin 2024 – 2025, e cila është në proces e sipër të përgatitjes.



Në përmbyllje shqyrtimit të kërkesave për staf shtesë dhe projekteve kapitale për vitin 2023-2025, Komisioni kërkoi ndryshimin dhe plotësimin e tyre, sipas vlerësimit të anëtarëve të tij, duke u mbështetur në arsyetimet përkatëse.

Aktivitetet e Sekretariatit të KPK-së

SKPK-ja ka mbajtur një takim me përfaqësuesin e Projektit MCC për definimin e kërkesave për zhvillimin e sistemit elektronik, i cili mundëson trajnimin (mësimin) nga distanca “e-learning”, përmes të cilit planifikohet trajnimi i stafit të sistemit prokurorial për përdorimin e të gjitha sistemeve elektronike që janë në përdorim, si dhe është mbajtur një takim me përfaqësuesin e projektit EUKOJUST, me ç’rast janë diskutuar planifikimet dhe aktivitetet e ardhshme në kuadër të këtij projekti.

Ndërkohë ka pasur një angazhim të shtuar në takimin e Komitetit Drejtues të Projektit të përbashkët BE-Këshilli i Evropës kundër krimit ekonomik (PECK III), i cili është mbajtur në Strasbourg, më 17 dhe 18 maj 2022, si dhe është përgatitur projekti për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e sistemit elektronik për menaxhimin e buxhetit, financave dhe pasurisë jofinanciare.

Gjithashtu, sipas kërkesës së ZKM-së, janë ofruar informata lidhur me zbatimin e prioritetëve të sistemit prokurorial në Agjendën e Reformës Evropiane për periudhën e raportimit janar-mars 2022.

Po ashtu janë inputet lidhur me zhvillimet sa i përket konkluzioneve të Nënkomitetit për Drejtësi, Liri dhe Siguri të Komisionit Evropian, të mbajtur në vitin 2021 dhe ka vijuar hartimi i Protokollit numër 1, në të cilin adresohet trajnimi i detyrueshëm në kuadër të Memorandumit të Mirëkuptimit në mes të KPK-së dhe Akademisë së Drejtësisë.

Aktivitetet e Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë

NJSHPP-ja gjatë muajit maj është fokusuar në hartimin e hartimin e raportit të punës së Prokurorit të Shtetit për tremujorin e parë të vitit 2022, hartimin e raporteve analitike të përcaktuara me Planin e Punës së KPK-së për vitin 2022, hartimin e raportit analitik për numrin e prokurorëve dhe ngarkesën dhe efikasitetin me lëndë të prokurorive themelore për periudhën 5 vjeçare (2017-2021), kontrollimin e të dhënave statistikore të nxjerra nga SMIL-i për të krahasuar saktësinë e shënimeve nga raportet e avancuara me raportet fizike që janë pranuar nga prokuroritë, në takimin e projektit KOSEJ të Këshillit të Evropës. Gjithashtu, pjesëmarrja e prokurorëve në trajnime ka vijuar me programet e specializuara të trajnimit për: pastrimin e parave dhe hetimin financiar, mashtrimin dhe korrupsionin në prokurimin publik, rikuperimin e pasurisë të vjedhura, dhunën në familje, lirinë e shprehjes dhe liria e mediave, krimi kibernetik dhe kriptovalutat, veprat penale kundër kafshëve, për shkathtësive e përfaqësimit në gjyqime, marrjen e deklaratës së fëmijëve viktimë nga eksperti.